



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 84-të të mbajtur më 30.03.2023 ka miratuar sa vijon

## VENDIM

Denoncimi I regjistruar sipas numrit 12-2012/1 të datës 26.05.2021, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-2012/1 të datës 26.05.2021 të mbyllet dhe të arkivohet

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më datë 26.05.2021, është dorëzuar denoncim dhe është formuar lënda me numër 12-2012/1 të datës 26.05.2021.

Denoncimi ngre pyetjen se cila është nevoja për kalimin e lirë të shtetasve serbë nëpër vendin tonë dhe për të lënë mënjane 3 milionë euro për kartat M, kur një dekret i thjesht mund të lejohet dhe urdhërohet kalimin e një kabine pagese për të gjitha automjetet me pasagjer serb. Në të njëjtën kohë, lind pyetja nëse është që dikush të marrë tender për prodhimin e kartave, apo të paguhet njësoj ai që e ka marrë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka pretendime apo paligjshmëri konkrete që tregojnë për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga zyrtarë të caktuar, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Në bazë të sa më sipër KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dorëzuar deri:

- parashtruesi i denoncimit

përpiloi: B.K.SH.

Miratoi: N.B., anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ ПЁР  
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Nёnkryetar  
Katica Nikolovska

